



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd



KODI ETIK

Aprovuar nga Këshilli Administrativ në datë 21 shtator 2024



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

INDEX

- 1. HYRJE**
- 2. MISIONI**
- 3. VIZIONI**
- 4. PËRFITUESIT**
- 5. SHPËRNDARJA E KODIT ETIK**
- 6. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA**
- 7. PERSONELI**
- 8. RREGULLATE E SJELLJES**
- 9. DISPOZITAT ZBATUESE**



DEFINICIONI

Fondacioni: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (me shkurtesën FNSBC), me seli në Tiranë, Rruga D. Hoxha, 123.

Subjekti: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë, me seli në Tiranë, Rruga D. Hoxha, 123.

Bashkëthemeluesit: Congregazione dei Figli dell’Immacolata Concezione, themeluar nga Luigi Maria Monti.

CdA ose Organi administrativ: Këshilli Administrativ i FNSBC.

OdV: Organ i Mbikëqyrjes.

Modeli: Modeli i organizatës, menaxhimit dhe kontrollit.

Raportimi: komunikimi me OdV për sjellje që nuk përputhen me Kodin.

Anëtarët/Përfituesit: anëtarët e organeve sociale, menaxhimi dhe punonjësit e Spitalit Katolik NSBC, specializantët, si dhe të gjithë ata që punojnë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Spitalit Katolik NSBC dhe që janë përfities të Kodit Etik.

Sistemi i qeverisjes: ligje, rregullore, etj. dhe modelet organizative dhe menaxhuese që, rregullojnë në çdo nivel menaxhimin dhe drejtimin e FNSBC.

Administrata Publike: institucionet publike, personat fizikë ose juridikë që veprojnë në cilësinë e funksionarëve publikë, etj.

Funksionar publik: ai që ushtron një funksion publik legjislativ, gjyqësor ose administrativ.

Niveli i lartë menaxhues: persona që mbajnë funksione përfaqësuese, administrative ose drejtues të Spitalit Katolik NSBC dhe/ose të një Njësive të saj.

Personeli: burimet njerëzore të angazhuara për kryerjen e aktiviteteve të Spitalit Katolik NSBC.

Punonjësit: subjekte që kanë një kontratë pune me Spitalin Katolik NSBC.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Konsulentët: subjekte që, për shkak të kompetencave profesionale, ofrojnë shërbimet e tyre në favor ose për llogari të Spitalit Katolik NSBC, mbi bazën e një mandati ose marrëdhënieje tjetër bashkëpunimi profesional.

Furnizuesit: palët kontraktuale të Spitalit Katolik NSBC, persona fizikë ose juridikë, me të cilat Spitali Katolik NSBC ka ndonjë formë bashkëpunimi të rregulluar me kontratë.

Praktikat më të mira: grupi i elementeve (procedurat, sjelljet, zakonet, etj.) që mund të merren si referencë dhe të përdoren për arritjen e rezultateve më të mira në punë.



HYRJE

Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2022 dhe është spitali i parë katolik jo fitim prurës që është hapur në Shqipëri.

Nga hapja e tij, kemi punuar për të ndërtuar një qendër mjekësore për diagnostikimin, aktivitetin kirurgjikal dhe trajtimin e sëmundjeve, ku pacienti me nevojat e tij, është në qendër.

Shëndeti dhe mirëqenia e pacientit janë prioritetet kryesore.

Kodi etik i Spitalit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë," i quajtur në vazhdim Kodi etik, përbën një pikë referimi për të gjithë komponentët e Spitalit lidhur me sjelljen gjatë punës dhe kërkimit, duke shprehur parimet, vlerat, angazhimet dhe përgjegjësitë etike që frymëzojnë aktivitetin e tij dhe duke ia paraqitur të gjithë organizatës si kritere të detyrueshme për qëndrimet/sjelljen e tyre gjatë realizimit të detyrave përkatëse brenda kësaj strukture.

Në veçanti, Spitali angazhohet, në përputhje me qëllimet dhe drejtimet e vendosura nga Magjisteri i Kishës Katolike në fushën e bioetikës, për të promovuar zhvillimin e çdo njohurie sipas një koncepti të shkencës që është në shërbim të personit njerëzor, në përputhje me natyrën universale të katolicizmit dhe me nevojat e tij të larta dhe specifike për liri.

Çdo Punonjës dhe Bashkëpunëtor angazhohet të abstenojë nga kryerja e procedurave, ndërhyrjeve, qëndrimeve që janë në kundërshtim me këto parime.

Ky Kod Etik i përmbahet gjithashtu rregullave të legjisllacionit të vendit dhe përbën një pjesë përbërëse të Modelit organizativ, menaxhues dhe kontrollues të Spitalit.



MISSIONE

Spitali Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (në formë të shkurter: Spitali) ka si mision ofrimin e ndihmës shëndetësore për pacientët që drejtohen në këtë strukturë, përmes integritit, në një sistem të vetëm, të një niveli të kualifikuar profesional, të arritjeve më të avancuara të shkencës dhe teknologjisë, si dhe të një referimi të qartë ndaj vlerave njerëzore dhe procedurave mjekësore, në respekt të personit të sëmurë.

Spitali është një institucion shëndetësor jo-publik dhe jo-fitimprurës, i dedikuar kujdesit dhe ndihmës për pacientët, me një vëmendje të vecantë ndaj sigurisë së protokolleve mjekësore dhe trajtimeve diagnostike e terapeutike, të kryera sipas standardeve evropiane bashkëkohore. Struktura komode dhe ambienti mikpritës favorizojnë një qasje të integruar të kujdesit për pacientin me kushtet më të mira për një shërbim të plotë.

- a) Spitali është një institucion në shërbim të shëndetit dhe ushtron aktivitetin e tij sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me standardet operative ndërkombëtare.
- b) Spitali, si njësi organizative e Fondacionit NSBC, vepron pa qëllim fitimi dhe me qëllim të ofrimit të ndihmës shëndetësore dhe shpirtërore për të sëmurët, në përputhje me mësimet e Atë Luigi Monti.
- c) Spitali ndjek, në shërbim të së mirës së përbashkët, përmirësimin e performancës shëndetësore përmes aplikimit të arritjeve më të avancuara shkencore dhe teknologjike, duke favorizuar zhvillimin e kërkimeve dhe transferimin e rezultateve të arritura.
- d) Spitali garanton përdorimin më efektiv të burimeve që ka në dispozicion për arritjen e aktiviteteve institucionale, duke garantuar transparencën e kritereve dhe procedurave vendimmarrëse.
- e) Vizioni i Spitalit është ti shërbejë “me shkencë dhe përkushtim” jetës dhe shëndetit të individëve dhe familjeve të tyre, pa asnjë dallim, në përmbushjen e misionit kristian për të kuruar të sëmurët, duke u frymëzuar nga Doktrina Sociale Katolike.



Spitali Katolik **Zoja e Këshillit të Mirë**

Përkushtuar Shëndetit Tënd

- f) Spitali përfaqëson një ambient të favorshëm për pacientët dhe familjet e tyre, si dhe një vend për rritje profesionale për stafin spitalor, duke promovuar formimin e vazhdueshëm me qëllim ngritjen e nivelit akademik-shkencor, në dobi të shëndetit të pacientit.



VIZIONI

Vizioni i Spitalit është të kujdeset për njerëzit e sëmurë dhe familjet e tyre pa asnjë dallim, në përmbushjen e misionit kristian për t'iu “gjendur” të gjithëve.

Në dritën e këtij trashëgimie etike dhe historike, ne synojmë të arrijmë qëllimet e mëposhtme:

- të përfaqësojmë spitalin e preferuar nga pacientët, mjekët dhe bashkëpunëtorët në Shqipëri, dhe gjithashtu në vende të tjera, për cilësinë dhe angazhimin në kujdesin shëndetësor;
- të jemi lider në Shqipëri dhe në rajon në përdorimin e teknologjive shëndetësore më të avancuara;
- të bëhemi një qendër akademike e zgjedhur nga profesionistët e sistemit shëndetësor dhe sektorëve të tjerë;
- të përbëjmë një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e komunitetit, duke përmbushur nevojën për shëndet me një ndihmë të orientuar drejt së mirës së përbashkët.

Angazhimi i vazhdueshëm i Spitalit është ekselencia e shërbimit të ofruar, përmes një investimi të duhur në burime njerëzore dhe zbatimit të praktikave të mira, të frymëzuara nga vlerat e mëposhtme:

1. **Shërbimi:** për një stil marrëdhënieje të ndjeshme ndaj pacientëve, që e karakterizon profilin operativ të Spitalit. "Shërbimi" është shprehja e mandatit ungjillor për të kuruar të sëmurët, e praktikuar gjithashtu nga themeluesi Luigi Maria Monti.
2. **Përgjegjësia:** si një përgjigje serioze ndaj një nevoje, shprehje e një ndjenje detyre të ndarë me të tjerët, e drejtuar drejt ndërtimit të besimit të ndërsjellë mes të sëmurëve, operatorëve shëndetësorë dhe familjeve.
3. **Respekti:** një qëndrim që respekton dinjitetin njerëzor të çdo personi pa kushte që lidhen me gjininë, moshën, statusin social, etninë, fenë apo karakteristika të tjera personale.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

4. **Ekselencia:** një vlerë profesionale e orientuar, që lidh njerëzit me rezultatet më të mira të kërkimeve shkencore dhe teknologjike, duke u mbajtur të frymëzuar nga një etikë e së mirës së përbashkët.
5. **Energjia:** një mënyrë veprimi generuese për të arritur rezultate që janë të pamundura për individin e vetëm. Spitali mbështetet në skuadra që nuk nxisin sjellje që favorizojnë individualizmin dhe forma të konkurrencës së ndërsjellë.
6. **Paanshmëria:** strukturat e Spitalit trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe paanshmërisht të gjithë subjektet me të cilat krijojnë marrëdhënie, në përputhje me këtë Kod dhe norma e statute të tjera lidhur me shërbimet ndaj personit. Qëndrimi i paanshëm buron nga respekti për njerëzit që kanë kulturë, fe e etni të ndryshme. I njëjti qëndrim kërkohet nga kushdo që frekuenton Spitalin.
7. **Objektiviteti:** në ushtrimin e funksioneve të tyre, përfaqësuesit dhe bashkëpunëtorët e Spitalit ruajnë një qasje objektive dhe të vetëdijshme për kompleksitetin e situatave, duke shmangur pozita në mosmarrëveshje mes pacientëve, kolegëve ose enteve, veçanërisht mbi çështje ideologjike.
8. **Barazia dhe mosdiskriminimi:** përfaqëson angazhimin për të trajtuar të gjithë në të njëjtën mënyrë, duke ofruar mundësi të barabarta pavarësisht nga kushtet personale dhe gjithësesi duke pasur preferencë për ata më të dobting.
9. **Integriteti:** përbën aftësinë për të përmbushur detyrën në mënyrë të ndershme dhe të kujdesshme, në respekt të vlerave që frymëzojnë profesionin e tij, normave publike dhe dispozitave që rregullojnë aktivitetin e Spitalit.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

PERFITUESIT

Kodi etik iu drejtohet të gjithë komponentëve të Spitalit Katolik, organeve të tij qendrore dhe palëve të treta që kanë marrëdhënie me Spitalin.

Në veçanti, konsiderohen si komponentë të Spitalit dhe për rrjedhojë si përfitues të Kodit Etik, në mënyrë ilustrative dhe jo përfundimtare:

- Marrësit e shërbimeve të spitalit;
- Punonjësit dhe bashkëpunëtorët e Spitalit Katolik NSBC;
- Mjekët në specializim;
- Furnitorët e Spitalit Katolik NSBC;
- në përgjithësi, të gjithë ata që punojnë për arritjen e qëllimit dhe objekteve të Spitalit Katolik NSBC.



SHPËRNDARJA E KODIT ETIK

Detyra për të promovuar njohjen e Kodit Etik të përfituesit e tij i përket Organit të Mbikëqyrjes (nga tani e tutje edhe "OdV"). Spitali ssynon për një ndarje dhe shpërndarje të Kodit dhe kërkon respektimin dhe aplikimin e tij nga çdo subjekt që vepron për llogari të Spitalit ose që vjen në kontakt me të. Në çdo rast, Spitali informon të gjithë subjektet përfituese të këtij Kodi për vlerat dhe parimet që përmban dhe garanton shpërndarjen e tij brenda dhe jashtë përmes: • shpërndarjes së Kodit të të gjithë komponentët e organeve të Fondacionit, të punonjësit dhe bashkëpunëtorët në çdo cilësi, • vendosjes së Kodit në dispozicion të palëve të treta, në faqen e internetit të Spitalit Katolik;

Çdo sjellje në kundërshtim me rregullat e përmbajtura në Kod do të duhet të raportohen te OdV që do të sjellë aplikimin e sanksioneve disiplinore dhe/ose kontraktuale për shkeljet eventuale të Kodit. Rishikimi i Kodit Etik miratohet me vendim të Këshillit Administrativ.



DISPOZITA TË PËBASHKËTA

4.1 Refuzimi i çdo diskriminimi të padrejtë

1.1 Spitali nuk pranon asnjë diskriminim të padrejtë. Të gjithë anëtarët e Spitalit kanë të drejtë të trajtohen si subjekte që kanë të drejta dhe vlera, me një frymë kuptimi dhe respekti të barabartë, dhe të mos përballen drejtpërdrejt ose tërthorazi me asnjë diskriminim të padrejtë.

1.2 Nuk ka diskriminim kur dispozita, kriteri ose praktika që themelojnë trajtimin e diferencuar janë objektivisht të justifikuara nga respekti për diversitetin, nga marrja parasysh e rastit konkret, ose nga një qëllim legjitim, dhe mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

1.3 Kjo konsiderohet si një rrethanë agravante e përgjegjësisë që rrjedh nga adoptimi i praktikave diskriminuese ose shfrytëzuese kur subjekti diskriminues abuzon me rolin e tij ndaj subjektit të diskriminuar.

4.2 Abuzime morale dhe seksuale

2.1 Spitali nuk toleron kryerjen, nga ana e ndonjërit prej anëtarëve të tij, të abuzimeve ose ngacmimeve morale dhe seksuale dhe siguron mbrojtjen e shpejtë të viktimave.

2.2 Abuzim ose ngacmim seksual përbëjnë sjelljet që përfshijnë kërkesa ose propozime për favore ose shërbime me përmbajtje seksuale dhe/ose sjellje ose shprehje që janë të drejtuara me një qëllim ofendues ose degradues ndaj aspektit seksual të një ose më shumë personave.

2.3 Një rrethanë agravante e abuzimit ose ngacmimit moral dhe seksual është kur ngacmimi seksual bëhet duke përfituar nga pozicioni në hierarkinë e spitalit.

4.3 Abuzimi me postin

3.1 Asnjë anëtar i Spitalit nuk lejohet të përdorë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, rolin e tij organizativ për të detyruar ose nxitur anëtarët e tjerë të Spitalit ose palë të treta që të kryejnë shërbime të favorshme për vete, për miqtë ose të afërmit e tij, përveçse kur kjo është e rregulluar ligjërisht ose nga rregullat e brendshme të spitalit.

4.4 Përdorimi i emrit, logos dhe reputacionit të Spitalit Katolik

4.1 Anëtarët e Spitalit janë të detyruar të respektojnë emrin e tij të mirë dhe të mos dëmtojnë reputacionin e Spitalit.



4.5 Përdorimi i emrit, logos dhe simboleve të Spitalit lejohet në kuadër të aktiviteteve institucionale të Spitalit. Çdo përdorim tjetër, edhe i tërthortë, lejohet vetëm nëse është autorizuar nga organet përkatëse me mënyrat dhe në rastet e parashikuara nga një rregullore e veçantë.

4.6 *Marrëdhëniet me mediat*

6.1 Marrëdhëniet me mediat duhet të bazohen në parime të vërtetësisë, korrektësisë dhe transparencës.

6.2 Asnjë anëtar i Spitalit nuk lejohet të veprojë në emër të Spitalit dhe të japë deklarata publike ose të drejtohet ndaj publikut (siç janë shkruarja e artikujve, dhënia e intervistave ose pjesëmarrja në programe informuese) nëse nuk është shprehimisht i autorizuar nga organet përkatëse.

4.7 *Konflikti i interesave*

a. Konflikti i interesave ekziston kur interesi privat i një anëtari të Spitalit është në konflikt aktual ose potencial me interesin, edhe të natyrës jo ekonomike, të Spitalit. Ky konflikt përfshin gjithashtu marrëdhëniet e jashtme të punës me institucione shëndetësore ose spitalet potencialisht konkurrencte.

7.2 Interesi privat, jo vetëm ekonomik, i një anëtari të Spitalit mund të lidhet me:

A. interesin e menjëhershëm të personit si anëtar i Spitalit;

B. interesin e një anëtari të familjes së një anëtari të Spitalit;

C. interesin e personave fizikë ose juridikë me të cilët anëtari i Spitalit ka një marrëdhënie pune ose tregtare;

D. interesin e personave juridikë të cilët anëtari i Spitalit kontrollon ose ka një pjesëmarrje të konsiderueshme financiare, ose për të cilët është administrator ose anëtar i organit administrativ ose të kontrollit;

E. interesin e të tretëve, nëse ata mund të përfitojnë në mënyrë të vetëdijshme për anëtarin e Spitalit.

F. Anëtari i Spitalit që, në një operacion të caktuar, ka interesa në konflikt me ato të Spitalit, duhet ta njoftojë menjëherë organin ose personin përgjegjës dhe duhet të abstenojë nga çdo vendimmarrje, propozim ose vendim në lidhje me të.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

4.8 Përdorimi i burimeve, shërbimeve dhe hapësirave të Spitalit

- a. Anëtarët e Spitalit janë të detyruar të përdorin burimet, shërbimet dhe hapësirat e Spitalit në një mënyrë të përgjegjshme, të kujdesshme, të denjë dhe transparente.
- b. Anëtarët e Spitalit duhet të justifikojnë shpenzimet e bëra me fonde të Spitalit dhe të prodhojnë dokumentacion të përshtatshëm ose raportime me kërkesë të Spitalit.
- c. Asnjë anëtar nuk lejohet, në mungesë të një autorizimi nga organet përkatëse të institucionit spitalor, të përdorë ose të japë për persona ose institucione të jashtme pajisje, shërbime, hapësira ose burime njerëzore, materiale ose financiare të Spitalit për qëllime personale dhe/ose për qëllime të ndryshme nga ato të përmbledhura në këtë Kod.
- d. Çdo anëtar i Spitalit duhet të respektojë rregulloret e Spitalit dhe të strukturave të tjera të Spitalit.

5. Përdorimi i aplikacioneve informatike

- e. Anëtarët e Spitalit janë të detyruar të përdorin pajisjet kompjuterike dhe softuerike të ofruara nga spitali ekskluzivisht për qëllime të lidhura me kryerjen e detyrave të tyre dhe, në çdo rast, në përputhje me qëllimet e tij. Në veçanti, anëtarët e Spitalit janë të detyruar:
 - A. të respektojnë procedurat e sigurisë të Spitalit, për të mos komprometuar funksionalitetin dhe nivelin e mbrojtjes së sistemeve informatike;
 - B. të mos duplikojnë abuzivisht programet e instaluara në kompjuterët;
 - C. të respektojnë procedurat e parashikuara për përdorimin e postës elektronike;
 - D. të mos navigojnë në faqe që nuk lidhen drejtpërdrejt me arsyet e zyrës dhe/ose shërbimit të tyre.

6 Siguria, shëndeti dhe higjiena

- f. Në kuadër të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, Spitali angazhohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur integritetin psiko-fizik dhe moral të anëtarëve të tij dhe të gjitha personave që punojnë ose qëndrojnë në hapësirat dhe strukturat e spitalit.
- g. Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë në punë duhet të konsiderohet gjithashtu edhe për subjektet që i përkasin ndërmarrjeve të jashtme që punojnë brenda Spitalit, të cilat janë të detyruara të respektojnë legjislacionin përkatës për të parandaluar rreziqet për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.



h. Në veçanti, Spitali angazhohet që:

- E. të respektojë legjislacionin në fuqi në fushën e sigurisë, higjienës dhe shëndetit të punonjësve të konsiderohet një prioritet;
- F. të alokojë burimet e duhura dhe të mjaftueshme për garancinë e sigurisë, higjienës dhe shëndetit të punonjësve;
- G. informacioni dhe formimi i punonjësve të jenë të azhornuaraa dhe specifike në lidhje me detyrën e kryer dhe procedurat e vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve;
- H. organizimi i punës dhe aspektet operative të saj të realizohen në mënyrë që të mbrohet shëndeti i punonjësve, të tretëve, pacientëve dhe të gjithë anëtarëve të komunitetit spitalor.

4.9 Të drejtat e pronës intelektuale

- a. Punonjësit e Spitalit janë të detyruar të respektojnë normat në fushën e pronës intelektuale. Autori i një krijimi intelektual që i përket Spitalit është i detyruar të mos e përdorë atë për qëllime private dhe të ruajë konfidencialitetin mbi rezultatet e arritura deri në momentin e shpërndarjes zyrtare.
- b. Spitali konsideron se rezultatet e kërkimeve shkencore, duhet të kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë, sic janë përcaktuar nga rregullorja përkatëse e Spitalit

4.10 Informacionet e fshehta

- a. Anëtarët e Spitalit janë të detyruar:
 - A. të respektojnë konfidencialitetin e personave ose subjekteve për të cilat Spitali mban informacion të mbrojtur;
 - B. të konsultojnë vetëm aktet, dosjet, databazat dhe arkivat në të cilat janë të autorizuar për akses, duke i përdorur ato në përputhje me detyrat e tyre dhe rregullat në fushën e privatësisë.
- b. Spitali respekton dispozitat në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të interesuara dhe miraton masa të përshtatshme sigurie për databazat në të cilat janë mbledhur dhe ruajtur të dhëna personale, për të parandaluar rreziqet e shkatërrimit dhe humbjeve, aksesit të paautorizuar ose trajtimit të paautorizuar.

4.11 Marrëdhëniet me furnizuesit

- a. Spitali menaxhon procesin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve sipas parimeve të transparencës dhe korrektësisë, duke u mbështetur në procedura të veçanta rregullatore.



- b. Transparenca në marrëdhëniet me furnizuesit garantohet përmes:
 - A. adoptimit të rregullave dhe mekanizmave të seleksionimit dhe menaxhimit të furnizuesve, që marrin parasysh besueshmërinë teknike, ekonomike si dhe kriteret e përgjegjësisë sociale;
 - B. përcaktimit të mënyrave të menaxhimit të furnizuesve, duke iu siguruar të gjithë furnizuesve dinjitet dhe mundësi të barabarta;
 - C. përcaktimit dhe zbatimit të kriterëve dhe sistemeve të monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të mallrave/shërbimeve të ofruara.

4.12 *Caktimi i detyrave profesionale*

- a. Spitali përdor kriterë për caktimin e detyrave profesionale të bazuara në parimet e kompetencës, transparencës dhe korrektësisë.
- b. Kompensimi dhe/ose shumat e paguara për çdo titull të natyrës profesionale duhet të dokumentohen siç duhet dhe në çdo rast të jenë proporcionale me aktivitetin e kryer, duke marrë parasysh edhe kushtet e tregut.

4.13 *Dhurata nga furnizuesit, konsulentët dhe të tretët në përgjithësi*

- a. Anëtarët e Spitalit ndalohen të kërkojnë oferta dhuratash ose përfitimesh. Ata gjithashtu janë të detyruar të refuzojnë çdo ofertë jo simbolike të dhuratave ose përfitimeve që mund të ndikojnë, edhe indirekt, në zhvillimin e aktiviteteve.
- b. Në marrëdhëniet private me furnizuesit, konsulentët dhe të tretët në përgjithësi, ndalohet të pranohet ose të premtohet para ose përfitime të tjera.

4.14 *Marrëdhëniet ekonomike me partitë politike, lëvizjet dhe shoqatat*

- a. Spitali nuk jep kontribute direkte ose indirekte për parti, lëvizje dhe shoqata politike, as për përfaqësuesit dhe kandidatët e tyre.

4.15 *Marrëdhëniet me Administratën Publike*

- a. Marrëdhëniet e Spitalit me Administratën Publike, funksionarët publikë ose subjektet e ngarkuara me një shërbim publik duhet të inspironen nga dispozitat ligjore dhe rregullat përkatëse dhe nuk mund të dëmtojnë në asnjë mënyrë integritetin dhe reputacionin e Spitalit.
- b. Pranimi i angazhimeve dhe menaxhimi i marrëdhënieve të çdo natyre me Administratën Publike, funksionarët publikë ose subjektet e ngarkuara me një shërbim publik, janë të



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

rezervuara ekskluzivisht për anëtarët e Spitalit të ngarkuar për këtë çështje dhe për personelin e autorizuar.

- c. Në çdo rast, këto subjekte janë të detyruara të ruajnë me kujdes të gjithë dokumentacionin lidhur me marrëdhëniet me Administratën Publike.

4.16 *Marrëdhëniet me Institucionet dhe Autoritetet Mbikëqyrëse*

- a. Spitali kujdeset për marrëdhëniet me institucionet publike dhe autoritetet mbikëqyrëse sipas parimeve të korrektësisë dhe profesionalizmit.
- b. Anëtarët e Spitalit janë të detyruar të verifikojnë që ndihmat publike, kontributet ose financimet e dhëna në favor të Spitalit, të përdoren për kryerjen e aktiviteteve ose realizimin e iniciativave për të cilat janë dhënë.

4.17 *Marrëdhëniet me Autoritetet Gjyqësore*

- a. Spitali bashkëpunon me Autoritetet Gjyqësore dhe me organet e deleguara prej tij.
- b. Në rast të verifikimeve, inspektimeve ose hetimeve, do të vihen në dispozicion të Autoritetit Gjyqësor të gjitha dokumentet ekzistuese, duke mënjanuar shkatërrimin ose ndryshimin e regjistrimeve, procesverbaleve, shkrimeve kontabël dhe çdo lloji tjetër dokumenti, si dhe dhënien e deklaratave të gabuara ose të fshehura apo nxitjen e të tjerëve për të bërë këtë gjë.

4.18 *Parandalimi i pastrimit të parave*

- a. Anëtarët e Spitalit janë të detyruar të verifikojnë, sa më shumë që është e mundur, informacionet e disponueshme mbi palët kontraktore, partnerët, furnizuesit dhe konsulentët, për të vlerësuar reputacionin dhe legjitimitetin e aktivitetit të tyre përpara se të krijojnë ndonjë marrëdhënie që përfshin marrjen e mallrave ose shumave të parave për Spitalin.

4.19 *Regjistrimet kontabël dhe bilancet*

21.1 Kontabiliteti duhet të bazohet rigorozisht në parimet e përgjithshme të vërtetësisë, saktësisë, plotësisë, qartësisë dhe transparencës së të dhënave të regjistruara.

21.2 Bilancet dhe të dhënat kontabël të Spitalit duhet të ofrojnë një përfaqësim të vërtetë dhe të saktë të situatës pasurore, ekonomike dhe financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.



PERSONELI

22. Rëndësia e personelit

21.1 Spitali e njeh rëndësinë e personelit dhe të çdo komponenti të tij.

21.2 Organizimi dhe ushtrimi i aktiviteteve teknike, drejtuese, burokratikë, administrative, kontabël, dhe operative frymëzohen nga parimi i ligjshmërisë, si dhe nga parimet e transparencës, mirëqenies dhe paanshmërisë, dhe i nënshtrohen parimeve të barazisë së mundësive, pjesëmarrjes në përcaktimin e objektivave të punës, vlerësimit të kompetencave dhe meritës, shfrytëzimit optimal të burimeve njerëzore, mirëqenies organizative, shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, dhe shpërndarjes efektive të përgjegjësisë.

21.3 Në veçanti, Spitali angazhohet të realizojë dhe të mbajë kushte pune funksionale për mbrojtjen e integritetit psikofizik të të personelit dhe respektimin e personalitetit të tyre moral, duke shmangur çdo lloj ndikimi të paligjshëm ose shqetësimi të padrejtë.

23. Zgjedhja e personelit

22.1 Në përputhje me qëllimet institucionale të Spitalit, vlerësimi i kandidaturave dhe zgjedhja e personelit që shfrytëzohet nga Spitali, bëhen në përputhje me rregulloret në fuqi, mbi bazën e nevojave operative dhe përputhjes me profilin profesional të kërkuar, duke njohur mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët.

22.2 Informacionet e kërkuara gjatë procesit të zgjedhjes janë ngushtësisht të lidhura me verifikimin e profilit profesional të pritur, duke respektuar sferën private të kandidatit.

22.3 Në kuadër të procesit të zgjedhjes, Spitali adopton metodologjitë që bëjnë sa më objektiv dhe të drejtpërdrejtë procesin e identifikimit të kandidatëve.

22.4 Spitali refuzon praktikat diskriminuese në zgjedhjen e personelit, si dhe çdo formë favoritizmi ose nepotizmi, dhe punëson ekskluzivisht në përputhje me llojet e kontratave të parashikuara nga legjislacioni, si dhe me parimet e Statutit dhe të këtij Kodi.

22.5 Zgjedhjet e personelit të kryera në përjashtim të paragrafëve të mësipërm duhet të jenë të argumentuara dhe t'i nënshtrohen miratimit të Drejtorit Administrativ.

24. Trajnimi dhe zhvillimi i personelit

23.1 Spitali, angazhohet të favorizojë rritjen e personelit, pa ndonjë formë diskriminimi të padrejtë. Spitali identifikon rrugë të përshtatshme për trajtimin e personelit në respekt të dinjitetit të



individëve.

23.2 Sistemi i vlerësimit menaxhohet në mënyrë transparente dhe objektive.

25. *Komunikimi dhe përfshirja e personelit*

24.1 Komunikimi me të gjithë personelin ka në bazë dëgjimin, dialogun, respektin ndaj individit dhe roleve, qartësisë dhe transparencës, si dhe bashkëpunimit.

24.2 Spitali beson në rëndësinë e përfshirjes së personelit për një rritje të ndjenjës së përkatësisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm. Ai parashikon mënyra dhe mjete komunikimi, duke i përshtatur ato nevojave të grupeve të caktuara.

26. *Menaxhimi i personelit*

25.1 Në përputhje me kriteret e efikasitetit të përgjithshëm të punës, Spitali përdor fleksibilitetin organizativ që lehtëson menaxhimin e situatave të aftësisë së kufizuar, të lindjes së fëmijëve dhe, në përgjithësi, kujdesit ndaj fëmijëve, në përputhje me dispozitat e ligjit.

25.2 Përgjegjësit e Njësive Organizative janë të detyruar të shfrytëzojnë dhe vlerësojnë të gjitha profesionet e pranishme në strukturë, në mënyrë që të favorizojnë zhvillimin dhe rritjen e çdo komponenti të personelit, përmes të gjitha mjeteve të përshtatshme.

26. *Detyrat e personelit*

26.1 Çdo komponent i personelit, është i detyruar të përmbushë në mënyrë të saktë detyrimet e parashikuara nga ligji. Për më tepër, ai është i detyruar:

A. të elabrojë me kujdes dhe profesionalizëm gjithë dokumentacionin që lidhet me aktivitetin e tij dhe ta arkivojë atë me kujdes, për të lejuar verifikime të mundshme nga subjekte të autorizuara;

B. të njohë dhe respektojë procedurat e brendshme, duke vepruar me ndershmëri, saktësi dhe transparencë në aplikimin e tyre, duke bërë që, kur është e mundur, të gjitha aktivitetet të dokumentohen dhe/ose të jenë të dokumentueshme;

C. të mos ndryshojë vërtetësinë e certifikatave ose atestimeve me vlerë ligjore;

27. *Konfliktet e interesit në veprimtarinë e personelit*

27.1 Në kryerjen e aktiviteteve, komponenti i personelit është i detyruar, në rast të një interesi të tijin, aktual ose potencial, ta njoftojë menjëherë për këtë, përkatësisht, shefin hierarkik dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore, duke u abstenuar nga çdo veprim që lidhet me situatën e njoftuar.

27.2 Asnjë nga personeli nuk mund të marrë përgjegjësinë për fusha, sektorë, struktura, funksione, drejtime ose departamente administrative ose asistenciale, as mund të jetë pjesë e komisioneve të vlerësimit, nëse ndër personat për të cilët është i thirrur të ushtrojë funksione koordinimi, orientimi,



Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

ose vlerësimi, ndodhen, në çdo cilësi dhe gjithashtu për një kohë të caktuar, bashkëshorti i tij, fëmijët, të afërmit ose bashkëjetuesit, dhe në çdo rast ata që janë të lidhur me të nga lidhje familjare ose afiniteti deri në gradën IV, ose komponentë, në çdo rast, të bërthamës së tij familjare.

27.3 Personeli gjithashtu është i detyruar të mos përfitojë personalisht nga mundësitë e biznesit që ka njohur gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.



RREGULLAT E SJELLJES NË AKTIVITETET ASISTENCIALE

28. Pozicionimi i pacientit

28.1 Personeli i Spitalit i angazhuar në aktivitetet asistencialë është i detyruar të kujdeset për pacientin dhe të krijojë një marrëdhënie të kujdesshme dhe transparente me pacientin dhe familjen e tij gjatë ofrimit të të gjitha shërbimeve shëndetësore (shërbime spitalore dhe në ambulator), në përputhje me vlerat katolike që frymëzojnë Spitalin dhe në respekt të kodeve etike të profesionit, si dhe të të drejtave të njohura në Kartën evropiane të të drejtave të pacientit të paraqitur në Bruksel më 15 nëntor 2002.

28.2 Personeli i Spitalit, i vetëdijshëm për ndjeshmërinë e sektorit në të cilin operojnë, duhet të marrin në konsideratë nevojat e pacientëve dhe familjarëve të tyre, përfshirë ato të natyrës etike, morale dhe shpirtërore.

28.3 Personeli i Spitalit është i detyruar të sigurojë pjesëmarrjen e pacientit në vlerësimin e shërbimeve të ofruara, përmes angazhimit të tij të drejtpërdrejtë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së asistencës së ofruar.

28.4 Spitali angazhohet për respektimin e kërkesave të ligjit për akreditimin e strukturave shëndetësore dhe asistencialë dhe siguron përputhshmërinë e detyrimeve operative me normat e brendshme dhe të jashtme që kanë për qëllim garantimin e një menaxhimi të shëndoshë dhe efikas.

29. Këshillimi etike mbi aktivitetet e eksperimentimit qoftë klinik ashtu edhe mbi kafshët

29.1 Personeli i Spitalit i angazhuar në aktivitetet asistencialë është i detyruar të drejtohet Komitetit Etik për aktivitetet e vlerësimit dhe verifikimit të protokolleve të eksperimentimit dhe të përputhen me opinionet dhe udhëzimet e sjellura nga Komiteti.

30. Dokumentacioni klinik dhe karteela e daljes nga spitali

30.1 Personeli i Spitalit i angazhuar në aktivitetet asistencialë është i detyruar të sigurojë një menaxhim të saktë të dokumentacionit klinik dhe të karteles së daljes nga spitali, për ta bërë atë të plotë, të vërtetë dhe të lexueshëm.

30.2 Personeli i Spitalit angazhohet gjithashtu të respektojë dhe zbatojë rregullat e përcaktuara nga procedurat specifike që lidhen me mënyrat operative për menaxhimin e saktë të hospitalizimeve dhe, në përgjithësi, të ofrimit të të gjitha shërbimeve shëndetësore, dhe të shmangin që këto aktivitete të orientohen drejt përfitimeve dhe kompensimeve të papajtueshme.



31. Profillet organizative në ofrimin e shërbimeve

31.1 Personeli i Spitalit siguron bashkëpunim dhe koordinim mes strukturave dhe operatorëve të ndryshëm për të garantuar asistencën më të mirë për pacientin.

31.2 Personeli i Spitalit është i detyruar të marrë pjesë në aktivitetet e monitorimit dhe përmirësimit profesional.

31.3 Personeli i Spitalit janë ëshë i gatshëm të promovojë dhe mbështesë marrëdhëniet me shoqatat që përfaqësojnë pacientët.

32. Listat e pritjes

32.1 Personeli i Spitalit i angazhuar në aktivitetet asistenciale angazhohet të menaxhojnë listat e pritjes për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në përputhje me parimet e barazisë, korrektësisë dhe prioritetit dhe të shmangë, përmes implementimit të sistemeve specifike të kontrollit, manipulimet e listave për përfitime personale.

32.2 Zbatimi i parimit të prioritetit është i garantuar nga respektimi i rendit kronologjik të rezervimeve, të cilit mund t'i bëhet përjashtim vetëm në rastet e shënuara në procedurat specifike të menaxhimit të miratuara nga Spitali, për shkak të arsyeve të urgjencës dhe interesit shkencor.



DISPOZITAT E ZBATIMIT

33. Hyrja në fuqi dhe përdorimi i Kodit etik

33.1 Kodi etik dhe ndryshimet e tij miratohen nga Këshilli Administrativ me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

33.2 Ky Kod miratohet me dekret nga Presidenti i Fondacionit NSBC dhe publikohet në faqen zyrtare të Spitalit. Data e hyrjes në fuqi të Kodit etik përcaktohet nga dekreti i miratimit të tij.

34. Zbatimi i Kodit etik brenda Spitalit

34.1 I gjithë personeli i Spitalit është i detyruar:

- A. të njohë Kodin etik dhe të informohet mbi praktikat përkatëse interpretative;
- B. të familiarizohet me rregullat e sjelljes që ruhen në këtë Kod dhe që lindin nga praktikat interpretative;
- C. të respektojë këtë Kod si një normë etike e sjelljeve individuale.

34.2 Ky Kod nuk zëvendëson parimet e përmbajtura në ligje, rregullore dhe Statut, por integrohet me dispozitat e aplikueshme qv kanë lidhje me të drejtat dhe detyrimet e personelit.

34.3 Respektimi i ligjeve të Shtetit dhe normave të Bashkimit Evropian, si dhe rregulloreve, protokolleve dhe procedurave të lëshuara nga Spitali, përveç se është juridikisht i detyrueshëm, konsiderohet gjithashtu në përputhje me qëllimet e Kodit etik.

34.4 Në asnjë rast, ndjekja e interesit të Spitalit nuk mund të justifikojë një sjellje të pa ndershme dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Kod.

34.5 Në respekt të së drejtë civile, penale dhe administrative, shkelja e vërtetuar e Kodit etik është një arsye për të vendosur sanksione disiplinore.

35. Zbatimi i Kodit etik ndaj të tretëve

35.1 Në marrëdhëniet kontraktuale, Spitali angazhohet të kërkojë nga të tretët respektimin e dispozitave të këtij Kodi, duke e specifikuar atë shprehimisht në çdo kontratë.

35.2 Nëse kërkohet, një kopje e Kodit etik do t'i dorëzohet të gjitha subjekteve që kanë marrëdhënie me Spitalin.

35.3 Në kuadër të marrëdhënieve me të tretët, Spitali është i detyruar:

- A. të informojë në mënyrë të shpejtë dhe adekuate mbi angazhimet dhe obligimet e parashikuara në këtë Kod dhe të kërkojë respektimin dhe zbatimin e tij;
- B. të mos vendosë, as të vazhdojë, marrëdhënie ekonomike me ata që refuzojnë shprehimisht të respektojnë, ose që në përgjithësi nuk respektojnë, dispozitat e këtij Kodi;



35.4 Në lidhje me furnizuesit, konsulentët, menaxherët dhe bashkëpunëtorët në përgjithësi, Spitali ka të drejtë të përfshijë në kontratat përkatëse klauzola që i referohen rasteve të shkeljes së këtij Kodi.

36. Shpërndarja e Kodit etik

36.1 Spitali promovon shpërndarjen më të gjerë dhe njohjen e Kodit etik dhe e mbështet respektimin e tij, përmes publikimeve, komunikimeve dhe çdo mjeti tjetër të konsideruar të përshtatshëm për këtë qëllim, gjithashtu bazuar në plane vjetore trajnimi të diferencuar në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e destinatarëve të ndryshëm.

36.2 Një kopje e shtypur e Kodit etik ruhet gjithmonë në Drejtorinë e Përgjithshme, Presidencën e Fondacionit NSBC, Drejtorinë Administrative, Drejtorinë Shëndetësore dhe në çdo Drejtori të strukturës.

36.3 Një kopje gjithashtu i dorëzohet çdo personi nga stafi në momentin e pranimit në punë.

36.4 Kodi etik është gjithmonë i disponueshëm në faqen zyrtare të Spitalit. Në të njëjtën faqe do të jepet informim i shpejtë dhe i përshtatshëm për ndryshimet interpretatimet e Kodit etik, pas eliminimit të çdo elementi të mundshëm që identifikon personat e përfshirë, përveç nëse këta kërkojnë që vendimet të publikohen plotësisht.

37. Sistemi i kontrolleve të brendshme

37.1 Personeli i Spitalit është i detyruar të promovojë në çdo nivel kulturën e kontrollit si një mjet për përmirësimin e efikasitetit të veprimit spitalor.

37.2 Në këtë perspektivë, çdo person nga stafi i Spitalit, veçanërisht nëse është përgjegjës për një funksion, zyrë, strukturë asistenciale, është i detyruar të respektojë me kujdes dhe përgjegjësi rregullat dhe procedurat dhe të ofrojë bashkëpunim maksimal me funksionet dhe organet e brendshme të ngarkuara me kontrollin, duke u treguar i gatshëm dhe bashkëpunues gjatë çdo aktiviteti të mbikëqyrjes dhe verifikimit të zbatimit të Kodit të Etikës.

37.3 Spitali promovon një sistem të koordinuar të kontrolleve të brendshme përmes kanaleve të përshtatshme të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, në kuadër të Modelit organizativ, menaxhimit dhe kontrollit të Spitalit.

38. Raportimet

Spitali identifikon mënyrat më të përshtatshme për raportimin e shkeljeve të Kodit etik.

38.2 Personeli i Spitalit dhe të tretët mund të raportojnë në çdo moment, në formë jo anonime, çdo fakt të konsideruar si shkelje, ose dyshim për shkelje, të Kodit etik te Drejtori i Përgjithshëm, i cili do të vlerësojë menjëherë raportimin, duke kontaktuar gjithashtu "raportuesin", si dhe përgjegjësin e shkeljes së supozuar dhe çdo subjekt të përfshirë potencialisht.



38.3 Personeli i Spitalit është i detyruar të bashkëpunojnë me aktivitetin hetimor dhe të sigurojnë qasje të lirë në të gjithë dokumentacionin e konsideruar të dobishëm.

38.4 Ata që kanë dërguar raportimet e përmendura në paragrafit të mëparshëm mbrohen nga çdo lloj hakmarrjeje ose veprimi që mund të përbëjë një formë diskriminimi ose ndëshkimi.

39. Sanksionet disiplinore dhe procedura disiplinore

39.1 Për shkeljet e vërtetuara të Kodit etik vendos një Autoritet kompetent në fushën përkatëse, i parashikuar nga një rregullore të veçantë. Deri në hyrjen në fuqi të rregullores, mbeten të paprekura kompetencat e përcaktuara nga dispozitat në fuqi.

39.2 Rregullorja e njëjtë përmban listën e sanksioneve të aplikueshme në rast të shkeljes së Kodit etik.

40. Përditësimi i Kodit etik

40.1 Kodi etik përditësohet me vendim të Këshillit Administrativ, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

41. Pavlefshmëria dhe skadimi

41.1 Kushdo që ka marrë një vendim dënimi ose aplikimi të dënimit me kërkesë të palëve, edhe nëse jo përfundimtar, për një krim të qëllimshëm, nuk mund të jetë pjesë e Organeve qendrore të Spitalit.

41.2 Asnjë nga personeli i Spitalit që, pas një shkeljeje të Kodit etik, ka marrë një masë disiplinore, nuk mund të emërohet ose zgjidhet në drejtimin e strukturave dhe/ose organeve administrative dhe/ose asistenciale.

42.3 Raste të tjera të pavlefshmërisë së kodit rregullohen nga një rregullore të veçantë

DREJTORI I PËGJITHSHËM

Natalino POGGI